

FEDERATA E KARATESË E KOSOVËS
KOSOVA KARATE FEDERATION



RREGULLORE E KOMISIONIT PËR MEDIA
DHE MARRËDHËNIE ME PUBLIKUN

Prishtinë, 2021

Komisioni për Media dhe Marrëdhënie me Publikun i FKK-së

I. Fushëveprimi

Kjo rregullore përcakton procedurat e rrjedhës së informacioneve në Federatën e Karatesë së Kosovës (më tutje: FKK) në planin e informimit, përkatësisht të funksionimit sa më të mirë të komunikimit të FKK-së me median dhe publikun, me ç'rast në mënyrë të drejtpërdrejtë siguron nivelin e kënaqshëm të transparencës për punën edhe aktivitetet e FKK-së në raport me opinionin publik.

II. Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Komisioni për media dhe marrëdhënie me publikun i Federatës së Karatesë të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KMMP) është trup punues i FKK-së, që në bashkëpunim dhe bashkërendim me zëdhënësin e Federatës së Kosovës është përgjegjës për informim të brendshëm dhe për atë publik të FKK-së dhe për komunikim me publikun përmes mediave elektronike dhe të shkruara.

Neni 2

Komunikimi, në kuptimin e kësaj rregulloreje, përfshin të gjitha mënyrat e shkëmbimit të informacionit në formë teksti, figurash, videosh dhe në forma të tjera.

II. Detyrat dhe përgjegjësitë e KMMP janë:

Neni 3

- a. Hartimi dhe publikimi i informacioneve, komunikatave për shtyp dhe informatave në lidhje me aktivitetet e FKK-së;
- b. Pjesëmarrja, në bashkëpunim me zëdhënësin e FKK-së, në organizimin e konferencave për shtyp të FKK-së;
- c. Sigurimi i të dhënave dhe informacioneve të nevojshme për kryetarin e Bordit të FKK-së dhe zëdhënësin me rastin e mbajtjes së konferencave për shtyp;
- ç. Mirëmbajtja, përditësimi dhe publikimi i informacioneve dhe dokumenteve të FFK-së në Ueb-faqe;
- d. Komunikimi me media për veprim të përbashkët për afirmimin e karatesë, të veprimtarisë së FKK-së dhe të rezultateve të punës dhe të atyre sportive;
- e. Informimin e publikut dhe qytetarëve për aktivitetet e FKK-së;
- ë. Informimin e publikut për rezultate të arritura në garat e organizuara nga FKK, në garat ndërkombëtare dhe për rezultatet e përfaqësueses së Kosovës në karate dhe të rezultateve individuale të përfaqësueses;
- f. Informimi i klubeve dhe anëtarësisë me vendimet e Bordit dhe të organeve të tjera të FKK-së;

g. Përgatitja dhe publikimi i revistës, doracakëve, buletineve, informatorëve dhe publikimeve të tjera;

h. Publikimi i agjendave, kalendarit të aktiviteve të FKK-së dhe organeve tjera, kalendarit të garave etj. përmes formave më të përshtatshme dhe më funksionale të komunikimit.

i. Organizimi dhe mirëmbajtja e arkivit të KMMP të FKK-së.

III. Kriteret e përzgjedhjes së kryesuesit të KMMP

Neni 4

1. KMMP do të përbëhet nga tre anëtarë, një kryeues dhe dy anëtarë.
2. Kryesuesi i KMMP do të përzgjedhet me konkurs të shpallur nga FKK-ja. Anëtarët tjerë të komisionit do të emrohen nga kryesuesi dhe ata/ato duhet të miratohen nga Bordi Ekzekutiv i FKK-së
3. Kriteret për përzgjedhje të kryesuesit janë si në vazdhim:
 - a. CV-ja
 - b. Njohja e rregullave të garave të karatesë
 - c. Niveli i lartë i arsimit
 - d. Përvojë në punën me medie
 - e. Përvojë 3 vjeçare aktive në aktivitete të karatesë në Kosovë
 - f. Përvojë në administrim të rrjeteve sociale dhe internetit në përgjithësi
 - g. Preferohet njohja e gjuhës angleze
 - h. Aplikacioni i FKK-së i plotësuar
4. Bordi Ekzekutiv i FKK-së në rast të dështimit të përmbushjes së detyrave të përcaktuara me këtë rregullore, mund të shkarkojë kryesuesin e KMMP.

IV. Organizimi

Neni 5

Komunikimi me median realizohet nëpërmjet një adrese zyrtare të posaçme, e-maili: xxxxxx, e cila vendoset në faqen zyrtare të FKK-së me emrin **Kontakti me median**, e vendosur brenda rubrikës **Media**.

Neni 6

Menaxhimi i e-mail adresës bëhet nga përfaqësuesi i autorizuar i komisionit për media.

Neni 7

1. Për vendimmarrjet e Bordit dhe aktivitetet më të rëndësishme të FKK-së, komunikimin e drejtpërdrejtë me median e bëjnë kryetari i Bordit ose, në

mungesë të tij, me autorizim të tij apo të Bordit – zëdhënësi dhe sekretari i FKK-s.

2. Në raste të caktuara, jashtëzakonshme, komunikimin me media e bën Sekretari i përgjithshëm i FKK-së, ose me autorizimin e Bordit – kryetari i KMMP.

Neni 8

Në rastet e pamundësisë së koordinimit me Bordin/kryetarin/sekretarin/zëdhënësin, kur një anëtar i joekzekutiv të Bordit i kërkohet intervistë, apo një pronocim a deklaratë publike mbi veprimtarinë e FKK-së, deklaratës apo intervistës i bashkangjitet shpjegimi se mendimi i shprehur reflekton mendimin e tij personal, e jo të FKK-së.

Neni 9

Konferencat për shtyp, si rregull, organizohen kur ngjarjet janë të rëndësisë së madhe, apo kur tematika është e gjerë dhe nuk mund të prezantohet e tëra në një deklaratë apo njoftim për shtyp.

Neni 10

Konferenca për shtyp caktohet me urdhër të kryetarit të FKK-së. Ftesat për media për konferencë shpërndahen përmes Komisionit për MMP.

Neni 11

Nuk lejohen:

1. dhënia e intervistave spontane, të paautorizuara, as nëpërmjet telefonit dhe as në rastet e vizitave të shkurtëra të gazetarëve në FKK apo në aktivitetet të FKK-së.
2. që rezultatet e garave, të cilat i organizon FKK, apo në garat e organizuara jashtë vendit dhe ku vendi ynë, apo klubet prezantohen në nivel shtetëror, t'i shpallin klubet. Ajo është kompetencë e KMMP të FKK-së.

Neni 12

Njoftimet zyrtare të FKK-së realizohen vetëm nga KMMP, pas konfirmimit nga Kryetari ose Sekretari i përgjithshëm.

Neni 13

Njoftimet nga FKK publikohen në gjuhën shqipe por mund të publikohet edhe në gjuhën angleze.

Neni 14

Mandati i anëtarëve të Komisionit për media dhe marrëdhënie me publikun zgjat katër (4) vjet.

Neni 15

Për punën e vet, komisioni për marrëdhënie me median dhe publikun i përgjigjet kryetarit dhe Bordit të FKK-s.

IV Zëdhënësi

Neni 16

Bordi i FKK-së, nëse e sheh të nevojshme, emron zëdhënësin e FKK-së.

Neni 17

Në punën e tij zëdhënësi bashkëpunon ngushtë me kryetarin e FKK-së, me Sekretarin e përgjithshëm dhe me KMMP-n.

Neni 18

Sipas detyrës, zëdhënësi merr pjesë në të gjitha mbledhjet e rregullta dhe të jashtëzakonshme të Bordit të FKK-së.

Neni 19

Zëdhënësi, në bashkëpunim me KMMP-n, i siguron të dhënat dhe informacionet e nevojshme për kryetarin, kur ai paraqitet drejtpërsëdrejti para mediave në konferencat për shtyp, në paraqitjet në programet e mediave elektronike, apo në prononcimet publike për çështjet me rëndësi lidhur me vendimet dhe aktivitetet të FKK-së nëpërmjet mediave elektronike dhe të shkruara.

Neni 20

Në rast të pamundësisë së pjesëmarrjes së kryetarit në paraqitjet publike, në bazë të autorizimit të tij, këtë e bën zëdhëndësi.

Neni 21

Për punën e tij zëdhëndësi i përgjigjet kryetarit dhe Bordit të FKK-s.

Neni 22

Mandatin e zëdhënësit e përcakton Bordi i FKK-s me vendim të veçantë.


V. Dispozitat përfundimtare

Neni 23

Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit të Bordit Ekzekutiv të FKK-së dhe nënshkrimi i kryetarit të FKK-së.

Prishtinë, 19 qershor 2021

Ismet Krasniqi


Kryetar